- A K T A K U Z Ë -
GRUPI I INTELEKTUALËVE TË KOSOVËS

"GRUPI I INTELEKTUALËVE" TË KOSOVËS

PROKURORIA PUBLIKE E QARKUT
PP.nr. 281/81
Datë 31 maj të vitit 1982
Prishtinë
MJ/ASH

GJYKATËS SË QARKUT
PRISHTINË
Në bazë të nenit 45 par. 2 pika 3 të Ligjit të procedurës penale, ushtrojë

AKTAKUZË

Kundër:

Halil Alidemes, i lindur më 13.III.1936 në fshatin Pozhoran, me banim të përhershëm tani në Prishtinë, magjistër i shkencave të historisë.

Ekrem Kryeziut, i lindur më 1.VI.1943 në Pejë, më banim të përhershëm tani në Prishtinë, me profesion regjiser në TV të Prishtinës.

Ukshin Hotit, i lindur më 16.VI.1943 në fshatin Krusha e Madhe, tani me banim të përhershëm në Prishtinë. Magjistër e shkencave politike, ligjerues në Fakultetin Filozofik – Katredra e Sociologjisë Politike.

Mentor Kaçit, i lindur më 7.VI.1952 në Gjakovë, me banim të përhershëm tani në Prishtinë, montazher në TV Prishtina, apsolvent i Fakultetit të Drejtësisë.

Hilmi Ratkocerit, i lindur më 15.VIII.1955 në fshatin Llugagji, apsolvent i Fakultetit Filozofik, sektori i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Prishtinë.

Ali Kryeziut, i lindur më 9. VIII.1950 në Pejë, ku dhe jeton të kryer Fakultetin Juridik.

Nezir Halitit, i lindur më 16.IX.1948 në fshatin Firajë, me banim të përhershëm tani në Ferizaj profesor i gjuhës shqipe, ka të kryer Fakultetin Filozofik – Drejtimi i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe.

Shemsi Reçices, i lindur më 2.IX.1952 në fshatin Gllavicë, Pf. Bablak, ku dhe jeton, profesor i filozofisë marksiste dhe logjikës. Fakultetin Filozofik dhe shkallën e tretë të studimeve.

Muharrem Fetiut, i lindur më 7.I.1945 në fshatin Peçan, KK Suharekë, me banim të përhershëm tani në Prishtinë, magjistër i shkencave të historisë.

I pandehuri Halil Alidema:

Që nga viti 1979 në takime dhe gjatë bisedave me të pand. Hilmi Ratkocerin dhe Nezir Halitin si dhe me persona tjerë në Ferizaj, filloj t'i përhapi qëndrimet e t'ia armiqësore në drejtim të realizimit të statutit për Republikën e Kosovës dhe të bashkimit të popullit shqiptar, e në këtë drejtim kërkojë përkrahje dhe angazhimin e këtyre, e pastaj pas demostratave armiqësore e kundërrevolucionare të muajit mars dhe prill të vitit 1981, në shumë takime, kontakte, ndeja dhe gjatë bisedave me të pand. Ekrem Kryeziun, Ukshin Hotin, Mentor Kaçin, Hilmi Ratkocerin, Nezir Halitin, Shemsi Reçicën dhe Muharrem Fetiun, në Prishtinë, Ferizaj dhe gjetiu, i përkrahu në tërësi demostratat, kërkesat dhe parullat e këtyre demonstrative, nga i pand. Ekrem Kryeziu muar dhe e lexojë materialin propagandistik nga revista "Liria" nr. 3 të organizatës ilegale "Marksiste - Leniniste të Kosovës" me titull "Lufta e popullit tonë është e drejtë dhe patjetër do të triumfojë", e pastaj këte e lexuan, e analizuanë dhe komentuanë së bashku edhe me të pand. Ekrem Kryeziun dhe Ukshin Hotin, nga i pand. Ukshin Hoti kërkojë që t'i shkruaj Organizatës së kombeve të bashkuara lidhur me

kërkesat e demostrantëve për statusin e "Republikës së Kosovës", në mënyrë që atje të nxitet përkrahja për këtë kërkesë, nga i pand. Hilmi Ratkoceri kërkojë që t'ia sigurojë geshtetnerin për shumzimin e matrialit propagandistik dhe që ai si dhe i pand. Nezir Haliti të angazhohen për masovizimin e qytetarëve për dalje në demostrata dhe shkruarjen dhe shpërndarjen e parullave dhe pamfleteve në Ferizaj, u furnizua me materialin propagandistik "Teoria dhe praktika e revolucionit" të Qendrës për edukimin marksist pranë Këshillit qendror të PKMLSHJ, të cilin pastaj ia dha për ta lexuar të pandehurit Ali Kryeziut. Nga i pand. Mentor Kaçi kërkojë që të mbledhë shenime dhe ta informojë lidhur me numrin, vendosjen dhe lëvizjen e forcave të APJ dhe natyre policore në territorin e Komunës së Gjakovës, si dhe llojin e armatimit dhe mjeteve transportuese të këtyre forcave, si dhe shënime për numrin e studentëve të cilët nuk kanë mundur të regjistrohen në fakultete dhe shkolla të larta të Univerzitetit të Kosovës, për shkak të pjesëmarrjes në demostrata e me qëllim që për këte t'i shkruajnë OKB, kinëse për padrejtësirat që u bëhen këtyre studentëve, nga i pand. Ekrem Kryeziu kërkojë dhe muar njoftime lidhur me objektet transmetuese të RTV të Prishtinës me qendër në Golesh dhe mundësinë e depërtimit fshehurazi në këtë transmetues si dhe për mundësinë e sigurimit të armëve në rast nevoje nga depot e RTV të Prishtines dhe atyre ushtarake për rreth këtij transmetuesi, me të pand. Ali Kryeziun e shqyrtuan nevojën e hikjes – largimit nga treva e Kosovës të njerit prej personave më të aftë dhe i cili gëzon autoritet të lartë në popull me qëllim për të krijuar kështu situatë të rëndë psiqike në opinion në drejtim të destabilizimit dhe krijimit të situatës së rëndë politike në RSFJ dhe i cili kishte për të vepruar në mënyrë armiqësore nga jashtë, pastaj në muajin nëntor të vitit 1981 i dha për detyrë këtij të pandehuri që pas shkuarjes në SHBA të kërkojë ndihmë materiale për blerjen e armëve nga emigrantët e atjehit, ndërsa gjatë pushimeve verore në Stamboll të Turqisë është takuar me konzullin e RPSSH në Stamboll, me të cilin bisedojë dhe e komentojë situatën dhe gjendjen politike në Kosovë pas demostratave, me këte ka kryer

veprën penale cenimi kontrarrevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP të RSFJ.

I pandehuri Ekrem Kryeziu

Pas demostratave armiqësore e kundërrevolucionare të muajit mars dhe prill të vitit 1981, në shumë biseda, kontakte dhe ndeja me të pandehurit Halil Alidemen dhe Ukshin Hotin, i përkrahu në tërësi demostratat, kërkesat dhe parullat e demonstratave, e pastaj në kërkesën e të pand. Halil Alidemes, këtij ia vizatojë skicën e objekteve transmetuese të RTP me qendër në Golesh, duke i spjeguar mundësinë e afrimit fshehurazi pa u vrejtur nga i vetmi rojtar që e ruanë këtë objekt dhe depërtimin në të për të mundur që të pengohet programi televiziv si dhe i ofroj të dhëna për mundësinë e sigurimit të armëve në rast nevoje nga depot e RTP për të cilat ka treguar se janë të mbyllura me dyer të konstrukcionit dhe prej materialit të dobët si dhe në depot ushtarake të cilat nuk janë mirë të ruajtura, nga i pandehuri Mentor Kaçi muar dhe e lexojë artikullin në formë të pamfletit nga revista "Liria" nr. 3 të organizatës ilegale "Marksiste-Leniniste të Kosovës" me titull "Lufta e popullit... ", e cila i është kushtuar demostratave në Kosovë, rezultateve dhe arsyeshmërisë së këtyre demostratave, të cilin pastaj ia dha të pandehurit Halil Alidemes e më vonë që të tre këta të pandehur e lexuanë dhe e komentuanë së bashku në shtëpinë e të pandehurit Ukshin Hotit, të ndërmjetsojë në mes të pandehurit Halil Alidemes dhe Ukshin Hotit lidhur me shkruarjen e apelit OKB nga i pand. Ukshin Hoti, si dhe së bashku me të pand. Ukshin Hotin në fshatin Krusha e Madhe, dëgjuan inqizime në shiritin magnetofonik të artikullit të gazetës së RPSSH "Zëri i Popullit" që është emituar në valët e radios dhe TV të Tiranës, në të cilin janë përkrahur demostratat, kërkesat dhe parullat e këtyre demostratave në Kosovë, ndërsa nga i pand. Ali Kryeziu u njoftua se me rastin e shkuarjes së këtij në SHBA do të angazhohet që të mbledhi ndihma në të holla nga emigrantët e atjehit për të blerë armë.-

me këte ka kryer veprën penale të cenimit kontrarrevolucionar të rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP të RSFJ.

I pandehuri Ukshin Hoti

Pas demostratave armiqësore dhe kontrarevolucionare të muajit mars dhe prill të vitit 1981, në shumë biseda, kontakte dhe ndeja me të pandehurit Halil Alidemen dhe Ekrem Kryeziun në Prishtinë dhe gjetiu, i përkrahu në tërësi demostratat, kërkesat dhe parullat e këtyre demostratave, e në biseda me këta është deklaruar se për fitimin e Republikës së Kosovës duhet me vazhduar aktivitetin e shkruarjes së parullave, shpërndarjes së pamfleteve dhe të shkatimit të akcidenteve me organet e sigurimit publik si dhe udhëheqësit politiko-shoqëror gjatë mbledhjeve të ndryshme nëpër organizata punuese dhe të OTH të LK e në këtë drejtim duhet mobilizuar masën e gjërë, pastaj muar për sipër që lidhur me kërkesën për statusin e Republikës së Kosovës t'i shkruajnë një apel OKB në mënyrë që atje të nxitet përkrahja për këtë kërkesë, me të pandehurit Halil Alidemen dhe Ekrem Kryzeiun e lexuan dhe e komentuan artikullin në formë të pamfletit nga revista "Liria" nr. 3 të Organizatës ilegale "Marksiste - Leniniste të Kosovës" me titull "Lufta e popullit tonë... ", e cila iu është kushtuar zhvillimit të demostratave, arsyeshmërisë së demostratave dhe të kërkesave të demostratave në Kosovë, pastaj së bashku me të pand. Ekrem Kryeziun në shtëpinë e dëshmitarit Xhemajl Dema në Krushë të Madhe dëgjuan inqizime në shiritin e mangetofonit të emitimit të artikullit të "Zërit të Popullit" në Radio dhe TV të Tiranës, ndërsa në shtëpinë e vet dy herë inqizoj në shiritin e magnetofonit artikuj tjerë të gazetës "Zëri i Popullit" që janë emituar në valët e radio dhe TV të Tiranës, me të cilët artikuj përkrahen demostratat e marsit dhe prillit të vitit 1981 në Kosovë dhe sulmohet sistemi i RSFJ, si dhe të pandehurit Ekrem Kryeziut i propozoj që pas shkuarjes legale në Greqi të kërkojnë azil politik në ambasadën e SHBA në Greqi ku pastaj të shkojnë në SHBA, prej ku do të vazhdonin veprimtarin armiqësore kundër RSFJ në drejtim të fitimit për statusin e Republikës së Kosovës,

- me këte ka kryer veprën penale të cenimit kontrarrevolucionar të rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP të RSFJ.

I pandehuri Mentor Kaçi

Pas demostratave armiqësore dhe kundërrevolucionare të muajit mars dhe prill të vitit 1981, në shumë biseda, kontakte dhe ndeja me të pandehurin Halil Alidemen, i përkrahu në tërësi demostratat, kërkesat dhe parullat e demostratave, pastaj sipas kërkesës së të pand. Halil Alidemes, muar për sipër mblodhi dhe i dha këtij informata lidhur me numrin, vendosjen dhe lëvizjen e forcave të APJ dhe të atyre policore, llojin e armtimeve dhe mjetet transportuese në teritorin e komunës së Gjakovës si dhe muar për sipër mbledhjen e shënimeve për numrin e studenëve, të cilët nuk kanë gëzuar të drejtën e regjistrimit nëpër fakultete dhe shkolla të larta të Univerzitetit të Kosovës, për shkak të pjesëmarrjes në demostrata në mënyrë që i pandehuri Halil Alidema pastaj t'i shkruaj për këtë OKB duke theksuar kinëse padrejtësirat që u bëhen këtyre shtudentëve, u furnizua me materialin propagandistik në formë të pamfletit nga revista "Liria" nr. 3 të organizatës ilegale "Marksiste-Leniniste të Kosovës" me titull "Lufta e popullit...", në të cilin përkrahen demostratat, kërkesat e këtyre demostratave dhe trajtohet arsyeshmëria e këtyre demostratave, të cilin e lexoj e pastaj ia dha të pand. Ekrem Kryeziut, i cili pasi e lexojë ia dha të pandehurit Halil Alidemes, e këta të dy e lexuan bashkarisht edhe me të pand. Ukshin Hotin dhe e komentuanë e analizuan në shtëpinë e të pandehurit Ukshin Hotit, - me këte ka kryer veprën penale të cenimit kontrarevolucionar të rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP të RSFJ.

I pandehuri Hilmi Ratkoceri

Që nga viti 1979 në Ferizaj dhe Prishtinë, pas takimit me të pand. Halil Alidemen, pranojë idetë e tijë që të angazhohet në veprimtarinë armiqësore në drejtim të realizimit të kërkesës për statusin e Republikës së Kosovës dhe të bashkimit të popullit shqiptar, e në këtë drejtim të pand. Halil Alidemen sipas kërke-

sës së tij, e njoftojë rreth shkruarjes së parullave me përmbajtje armiqësore në shkollën e mesme ekonomike në Ferizaj në vitin 1979 dhe përmbajtjen e këtyre parullave si dhe thyerjes së fotografisë së Shokut Tito dhe kush prej nxënësve i ka kryer këto akcione, dhe masat që janë ndërmarr ndaj tyre, e pastaj pas demostratave armiqësore dhe kontrarevolucionare të muajit mars dhe prill 1981, në shumë biseda dhe kontakte me të pand. Halil Alidemen, i përkrahu demostratat, kërkesat dhe prullat e demostratave e në drejtim të realizimit të këtyre kërkesave dhe parullave, të pandehurit Halil Alidemes i premtojë sigurimin e geshtetnerit për shumzimin e materialit propagandues, pastaj pranojë që ta informojë për diskutimet në mbledhjet e OTHLK në shkollën ku jepte mësim, si i gjykojnë demostrantëve, e vet muar për sipër të veprojë në masovizimin edhe me persona tjerë për të vepruar në këtë drejtim e kështu kontaktojë dhe angazhojë edhe persona tjerë për të cilën gjë pastaj e njoftoj të pand. Halil Alidemen, i cili e caktoj datën për të shkuar dhe kontaktuar në Ferizaj me këta persona dhe për t'i furnizuar me material propagandues me përmbajtje armiqësore si dhe për t'i udhëzuar për vazhimin e punës me shkruarjen dhe shpërndarjen e parullave dhe pamfleteve me karakter armiqësor, në mëyrë që ta elektrizojë dhe frymzojë masën në drejtim të kërkesës që Kosova të fitojë statusin e Republikës, - me këtë ka kryer veprën penale të cenimit kontrarrevolucionar të rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP të RSFJ.

I pandehuri Ali Kryeziu

Pas demostratave armiqësore e kontrarevolucionare të muajit mars dhe prill të vitit 1981, në shumë biseda dhe ndeja në Prishtinë me të pandehurin Halil Alidemen, i përkrahu në tërësi demostratat, kërkesat dhe parullat e demostratave dhe u deklaruan se duhet vazhduar edhe mëtutje me shkruarjen e parullave dhe shpërndarjen e pamfleteve, nga i pand. Halil Alidema e muar dhe e lexoj pamfletin e Qendrës për edukimin marksist pranë KQ të PKMLSHJ me titull "Teoria dhe praktika e revolucionit" për përmbajtjen e të cilit është shprehur në supërlativ dhe

se duhet vazhduar aktivitetin në drejtim të realizimit të qëllimeve të parashtruara në këtë pamflet duke angazhuar të gjitha strukturat e kombsisë shqiptare, së bashku e parashtrojnë nevojen e emigrimit në RSP të Shqipërisë, të personit më të aftë dhe i cili gëzon autoritet në popullin e Kosovës, i cili prej atjehut kishte për t'i përkrahur kërkesat e parashtruara në demostrata për statusin e Republikës së Kosovës, si dhe me rastin kur deshi të shkojë në muajin nëntor të vitit 1981 në SHBA, muarë për sipër angazhimin që nga emigrantët e atjehut të mbledhi ndihma në të holla për blerjen e armëve, e për këte e njoftojë edhe të pandehurin Ekrem Kryeziun,- me këte ka kryer veprën penale të cenimit kontrarrevolucionar të rregullimit shoqëror, nga neni 114 të LP të RSFJ.

I pandehuri Nezir Haliti

Pas demostratave armiqësore dhe kundërrevolucionare të muajit mars të vitit 1981, në takim dhe bisedë me të pand. Halil Alidemen i përkrahu në tërësi kërkesat dhe parullat e demostratave, dhe muar për sipër që të angazhohet në drejtim të masovizimit të nxënësve të shkollës fillore ku punon dhe disa punëtor tjerë të arsimit që të organizojnë dhe dalin në demostrata në Ferizaj, dhe të brohoritin e të parashtrojnë kërkesë, me të cilat kërkohet që Kosova të fitojë statusin e Republikës, e pas mbajtjes së demostratave në Ferizaj, të pandehurit Halil Alidemes në Prishtinë i raportoj mbi zhvillimin e demostratave, pjesmarrjen e rinisë në to, organizimin e mirë, suksesin e tyre e pastaj pas bisedës me të pand. Halil u pajtua për vazhimin e mëtejmë të kërkesës që Kosova të fitojë statusin e Republikës, me shkruarjen e parullave dhe shpërndarjen e afisheve për ta elektrizuar dhe nxitur masën e gjërë si dhe të përcillet disponimi i tyre, -me këte ka kryer veprën penale të cenimit kontrarrevolucionar të rregullimit shoqëror, nga neni 114 të LP të RSFJ.

I pandehuri Shemsi Reçica

Pas demostratave armiqësore e kontrarrevolucionare të muajit mars dhe prill të vitit 1981, në shumë biseda, kontakte dhe

ndeja me të pandehurin Halil Alidemen në Prishtinë, i përkrahu demostratat, kërkesat dhe parullat e parashtruara në këto demostrata për statusin e Republikës së Kosovës, duke theksuar se duhet vazhduar me shkrimin e parullave, shpërndarjen e afisheve si dhe për përpjekjen që ato të jenë sa më masovike dhe kështu të mbahet situata e acaruar gjer në pranverën e vitit 1982, kur duhet shkuar në akcione konkrete nëse gjerë atëher nuk fitohet statusi i Republikës së Kosovës, duke theksuar se për të gjitha këto vet është i gatshëm sikur edhe populli i mbarë, ndërsa më 15 tetor të vitit 1981 në shtëpinë e Xhevat Reçices në fshatin Gllavicë, musafirëve të pranishëm u ka folë që edhe më tej duhet të vazhdohet me kërkesat që Kosova të bëhet Republikë dhe se deri te realizimi i qëllimit të kësaj kërkese do të vihet me hatër apo me dhunë dhe me luftën e popullit për të drejtat e veta, ndërsa në shtëpinë e vet në fshatin Gllavicë dy herash në shiritat e magnetofonit ka inqizuar dy artikuj të "Zërit të Popullit" që janë emituar përmes TV të Tiranës, në të cilët përkrahen demostratat dhe kërkesat e demostratave si dhe sulmohet sistemi i RSFJ dhe udhëheqësisë së sajë, ndërsa gjatë pushimeve verore të vitit 1981 në Varnë të Bullgarisë kontaktoi me përfaqësuesit e konzullatës së RPSSH, me të cilët bisedojë dhe e analizojë situatën dhe gjendjen politike në Kosovë pas demostratave, - me këte ka kryer veprën penale të cenimit kontarrevolucionar të rregullimit shoqëror, nga neni 114 të LP të RSFJ.

I pandehuri Muharrem Fetiu

Pas demostratave armiqësore dhe kontrarrevolucionare të muajit mars dhe prill 1981 në Kosovë, gjatë bisedave të përditëshme dhe kontakteve me të pand. Halil Alidemen dhe eksponimeve, propozimeve konkrete në drejtim të ndërmarrjes së veprimeve armiqësore që ia ka bërë i pand. Halil Alidema në Prishtinë, si dhe me rastin kur i ka përkrah demostratat, parullat dhe kërkesat e demostratave si dhe shprehjen për nevojën e organizimit dhe vazhdimit të veprimtarisë armiqësore ka ditë se po përgaditet kryerja e veprës penale për të cilën sipas Ligjit mund të jepet denimi me burgim prej 5 vjetëve dhe më i rëndë, nuk e

ka kallëzuar në kohën kur ende ka qenë e mundur që të parandalohet kryerja e sajë, kurse vepra penale e cenimit kontrarevolucionar të rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP të RSFJ është kryer nga i pand. Halil Alidema,- me këte ka kryer veprën penale mosëkallëzimi i pregaditjes së veprës penale nga neni 172 al. 1 të Ligjit penal të Kosovës.

Prandaj,

P R O P O Z O J

Që pranë asaj gjykate të caktohet dhe të mbahet seance gjyqësore publike në të cilën të ftohen:

Prokurori publik i qarkut në Prishtinë,

Të pandehurit:

Halil Alidema, Ekrem Kryeziu, Ukshin Hoti, Mentor Kaçi, Hilmi Ratkoceri, Ali Kryeziu, Nezir Haliti, Shemsi Reçica, të cilët ndodhën në paraburgim, si dhe Muharrem Fetiu, nga Prishtina, laxha "Dardania" blloku IX/IV nr. 23.

(...)

Gjatë administrimit të provave të lexohen: pamfletet "Teoria dhe praktika e revolucionit" të Qendrës për Edukimin Marksist pranë KQ të PKMLSHJ dhe "Lufta e popullit tonë është e drejtë dhe patjetër do të triumfojë" të revistës "Liria" organ i grupit "Marksist-Leninist të Kosovës" si dhe ai me titull "Teoria praktike e revolucionit për çlirimin kombëtar të shqiptarëve në Jugosllavi" i PKMLSHJ.

Të ushtrohet shiqim në fotodokumentacionin nr. 2435 të dt. 15 nëntor 1981.

A R S Y E T I M I

Sipas kërkesës së kësaj Prokurorie, pranë Gjykatës së qarkut në Prishtinë, janë zhvilluar edhe kryer hetimet kundër të pandehurëve: Halil Alidemes dhe Ali Kryeziut për vepra penale bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al. 1 lidhur me nenin 114 të LPJ, gjegjësisht nga neni 136 al. 2 lidhur me nenin

114 të LPJ dhe për veprën penale të spiunazhit nga neni 128 al. 1 të LP të RSFJ, Ukshin Hotit, Ekrem Kryeziut, Hilmi Ratkocerit, Nezir Halitit, Mentor Kaçit, Shemsi Reçices dhe Muharrem Fetiut, për veprën penale të bashkimit për veprimtari armiqësore nga neni 136 al. 2 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ.

Pas kryerjes së hetimeve me provat e propozuara, vërtetohet ekzistimi dhe kryerja e veprave penale nga të pandehurit në mënyrën e përshkruar në dispozitiv të kësaj aktakuze.

Kështu i pand. Halil Alidema në deklaratën e dhënë gjatë hetuesisë spjegon se që moti ka krijuar bindjen se zhvillimi i gjithëmbarshëm i KSA të Kosovës nuk është adekuat me zhvillimin e gjithëmbarshëm të vendit dhe këte e ka shprehë në biseda dhe kontakte me njerzit e njohur dhe të panjohur. Duke u bazuar në një gjendje të këtillë të pavolitshme ekzistuese në krahinë siq janë problemi i papunsisë, standardit të ultë etj. Ka supozuar se mund të vijë gjer ke protestet masovike në Kosovë e ndoshta në këtë drejtim edhe ka biseduar me njerëz, por nuk ka patur kurrëfar njohurish që në të vërtetë do të vijë gjer ke demostratat, e mund të jetë që njerëzit kanë krijuar bindjen që me të vërtetë ka ditë dhe ka qenë në lidhshmëri për fillimin e demostratave.

Pas zhvillimit të demostratave një ditë në oborrin e shtëpisë së vet e gjenë materialin propagandistik "Teoria dhe praktika e revolucionit" të Qendrës për edukimin marksist pranë KQ të PKMLSHL dhe prej atëherit datojnë angazhimet e t'ia që të mirret me këtë organizatë, për të cilën gjë ka qenë i interesuar edhe më parë, por nuk ka ditë se ç'far është dhe si quhet derisa ka mësuar prej materialit në fjalë. Pas mbajtjes së demostratave dhe gjetjes së këtij materiali, vazhdon angazhimin e vet të veprimtarisë në drejtim të realizimit të kërkesës për statusin e Republikës së Kosovës, dhe në këtë drejtim në kontakte dhe ndeja fillon të bisedojë me të pandehurit Ekrem Kryeziun, Ukshin Hotin, Shemsi Reçicen, Mentor Kaçin, Ali Kryeziun, Hilmi Ratkocerin, Nezir Halitin, të cilët në tërësi i përkrahin demostratat dhe kërkesat që janë parashtruar në demostrata si dhe me të pand. Muharrem Fetiun dhe dhëndrrin e vet Zija Hoxhen dhe me persona tjerë, e duke u eksponuar që të lë për-

shtypjet te këta se i takon organizatës ilegale. Dhe gjatë këtyre bisedave e vëren edhe disponimin e këtyre të pandehurve, andaj kontaktet, ndejat dhe bisedat me këta tani janë më të shpeshta.

Me një rast i pand. Ekrem Kryeziu ia jep materialin propagandistik në formë të pamfletit nga revista "Liria" nr. 3 të organizatës "Marksiste-Leniniste të Kosovës" me titull "Lufta e popullit tonë është e drejtë dhe patjetër do të triumfojë" kushtuar demostratave të marsit dhe prillit të vitit 1981 në Kosovë, me ç'rast i pand. Ekrem i tregon se këtë material e ka marrë nga i pandehuri Mentor Kaçi.

Pas kësaj kur është këthyer nga pushimi veror që e ka kaluar në Stamboll të Turqisë dhe pasi të pand. Mentor Kaçi i tregojë se atje është takuar dhe ka biseduar me konzullin e RPSSH në Stamboll, kërkon nga ky që të mbledhë shënime mbi numrin e forcave të APJ dhe atyre policore, llojin e armatimeve si dhe automjeteve dhe vendosjen e tyre në komunën e Gjakovës e pastaj edhe mbledhjet e shënimeve për numrin e studentëve të cilëve nuk u është mundësuar regjistrimi në fakultete dhe shkolla të larta të Univerzitetit të Kosovës për vitin shkollor 1981/82 për shkak të pjesëmarrjes në demostrata duke i thënë se për mosregjistrimin e studentëve do t'i shkruajë një peticion OKB me ç'rast do të theksonte padrejtësirat që po i bëhen rinisë kosovare. Më vonë i pandehuri Mentor Kaçi i sjell shenime duke e njoftuar se në Gjakovë përafërsisht ka rreth 2.000, ushtar të cilët janë të vendosur në afërsi të "Erenikut", se kanë 20 kamiona që tërheqin armë artilerike, se në qytet janë vrejtë 14-15 tanksa dhe se ka milicioner të mobilizuar dhe se forcat e sigurimit publik jashta krahinës nuk vërehen në Gjakovë.

Gjatë bisedave me të pandehurin Ekrem Kryeziun i përkrahin në tërësi demostratat duke theksuar se kjo është dëshira e popullit shqiptar dhe se ato paraqesin një formë të luftës për të fituar Republikën, e konstatojnë se nëse kështu nuk do të mund të arrihet qëllimi duhet shkuar deri në fund dhe të drejtat t'i realizojnë me kryengritje të armatosur. Në këtë rast armët do të sigurohen nga depot e RTP për të cilat i pandehuri Ekrem ka thënë se janë të mbyllura me dyer prej konstrukcionit dhe materialit të

dobët dhe se leht mund të thehen, si dhe duke i vjedhur nga depot e njësive teritoriale për të cilat gjithashtu i pandehuri Ekrem ka thënë se nuk janë mirë të siguruara dhe të ruajtura.

Duke ializuar mundësitë e çdo njenit dhe aktivitetin për t'i kontribuar "luftës që Kosova të fitoj statusin e Republikës" i pand. Ekrem i ka theksuar në angazhimin për të bërë pengesa në emitimin e programit të RT të Prishtinës në transmetuesin në Golesh dhe me atë rast sipas kërkesës së këtij, të pand. Halil, ia vizaton skicën e objekteve të këtij transmetuesi dhe sqaron në ç'drejtim do të mund t'i afrohej pa u vrejtë nga i vetmi rojtar që e ruanë këtë objekt.

Të gjitha këto Ekremi i kishte vrejtë gjatë kohës kur ishte në ushtrime ushtarake dhe i mobilizuar.

Gjatë kontakteve dhe bisedave me të pandehurin Ukshin Hotin në prezencën edhe të pandehurit Ekrem Kryeziut dhe në ato veç e veç, spjegon më tej i pand. Halil Alidema, i pand. Ukshin i ka përkrahë demostratat dhe kërkesat e parashtruara në këto demostrata si dhe organizimin e mirë të tyre me ç'rast e ka potencuar nevojën e vazhdimit të aktivitetit me shkrimin e parullave, shpërndarjen e pamfleteve si dhe të asaj për shkaktimin e akcidenteve në organet e sigurimit publik si dhe udhëheqsit politiko-shoqëror gjatë mbledhjeve të ndryshme nëpër organizata punuese dhe OTHLK për të cilën gjë duhet mobilizuar masën e gjërë e për ta mbajtur kështu popullin në gjendje gadishmërie e të gjitha këto do të ndikojnë në fitimin e statutit të Republikës së Kosovës. Në pranverën e vitit 1982 kur kushtet atmosferike janë më të volitshme ka thënë se përsëri duhet mobilizuar masën për kërkimin e Republikës e nëse përsëri në këtë mënyrë nuk do të arrihet qëllimi, duhet shkuar edhe në akcione konkrete.

Pasi e lexojnë dhe e komentojnë materialin në formë të pamfletit nga revista "Liria" nr. 3 të organizatës "Marksiste-Leniniste të Kosovës" me titull "Lufta e popullit..." tre të pandehurit në shtëpinë e Ukshin Hotit, e aktualizojnë çështjen e shkruarjes të një apeli OKB për gjendjen e vërtetë sipas shiqimit të tyre në Kosovë dhe njëherit të kërkojnë ndihmë dhe përkrahje

për realizimin e statusit të Republikës të cilën detyrë e merr mbi veti i pandehuri Ukshin.

Pas mbajtjes së demostratave në muajin mars 1981 në Prishtinë shkon në Ferizaj, ku takohet me të pandehurin Nezir Halitin, të cilin e njoftojë për zhvillimin e demostratave, ecuritë dhe kërkesat e parashtruara, me ç'rast i pandehuri Nezir i përkrah në tërësi demostratat dhe kërkesat e parashtruara dhe sipas propozimit të këtij dhe shtruarjes së nevojës që edhe në Ferizaj të organizohen këso demostratash me parashtrimin e të njejtave kërkesa dhe të angazhimit të të pandehurit Nezir në drejtim të organizimit të këtyre demostratave, Neziri pajtohet me këtë propozim me ç'rast ka deklaruar se në QAMO në Ferizaj ka 2-3 njerz nga radhët e punëtorëve të arsimit të cilët mund t'i angazhojë kurse me shumë mundësi në këtë plan ka në shkollën fillore ku është i punësuar dhe merrën vesh për brohoritjen e parullave në demostrata në të cilat të kërkohet që Kosova të fitojë statusin e Republikës dhe që ato të jenë sa më masovike.

Pas mbajtjes së demostratave në Ferizaj, i pand. Nezir ka ardhë në Prishtinë dhe në vendin e punës e ka njoftuar Halilin mbi zhvillimin e demostratave, pjesmarrjen e gjërë të masës, ecuritë e tyre, organizimin e mirë dhe se kanë qenë të suksesshme, pas të cilit njoftim ky, i pand. Halil thot se edhe mëtutje të vazhdohet me parashtrimin e të njejtës kërkesë dhe të mbahet popull, e në këtë gjendje duke shkruar dhe shpërndar afishe si dhe të përcillet disponimi i qytetarëve e në të gjitha këto i pandehuri Nezir është pajtuar dhe është dakorduar të vazhdoj punën. Disa ditë pas kësaj bisede Halili për të gjitha këto e njofton të pandehurin Ukshin Hotin, i cili thot "Mirë është, duhet vazhduar".

Gjatë kontakteve dhe ndejave pas demostratave të marsit dhe prillit 1981 me të pand. Shemsi Reçicen e bëjnë analizën e zhvillimit të demostratave dhe çdo herë i pand. Shemsi, si edhe ky, i përkrahë këto demostrata dhe kërkesat e parashtruara, duke u shprehur për arsyeshmërinë e mbajtjes së këtyre demostratave dhe parashtrimin e kërkesave për statusin e Republikës, me ç'rast ka theksuar nevojën e vazhdimit të mëtejmë dhe nëpër masa edhe më të mëdha, të shkruarjes së parullave, shpërndarjes

së afisheve, duke potencuar se nëse në këtë mënyrë nuk fitohet Republika, duhet shkuar në akcione konkrete për çka edhe vet si edhe populli mbarë është i gatshëm dhe se në këtë drejtim i ka të gatshëm edhe njerzit e vet, e të gjitha këto duhet realizuar në vitin 1982 në pranverë kur kushtet klimatike janë më të volitshme për akcione konkrete.

Për orjentimin e tij armiqësor, për përkrahjen e demostratave dhe kërkesave të parashtruara, pastaj për ekzistimin e organizatave ilegale, materialet e të cilave i ka lexuar, antarsimin në to e shumë gjëra të tjera i ka folë edhe të pand. Muharrem Fetiut, nga i cili edhe ka kërkuar që të angazhohet në teritorin e KK të Suharekës të organizojë njerz për një veprimtari të këtill të cilën i pand. Muharrem nuk e ka pranuar.

Edhe me të pand. Ali Kryeziun i kanë analizuar dhe komentuar demostratat e marsit dhe të prillit 1981 në shumë biseda dhe ndeja me te, me ç'rast Aliu në tërësi i ka përkrahë demostratat, parullat dhe kërkesat e parashtruara, me ç'rast është deklaruar se duhet vazhduar edhe më tutje me shkruarjen e parullave dhe shpërndarjen e pamfleteve e të njejtit ia ka dhënë për ta lexuar pamfletin e Qendrës për edukimin marksist pranë KQ të PKMLSHJ me titull "Teoria dhe praktika e revolucionit" dhe pasi e ka lexuar është shpreh në superlativ për përmbajtjen e këtij pamfleti duke theksuar se duhet vazhduar aktivitetin në drejtim të realizimit të qëllimeve të parashtruara në këtë pamflet, duke i angazhuar të gjitha strukturat e kombsisë shqiptare e pastaj së bashku e parashtrojnë nevojën e emigrimit në RPS të Shqipërisë të personit më të aftë dhe i cili gëzon autoritet në mbar popullin e Kosovës, i cili prej atjehit kishte për t'i përkrahur kërkesat e parashtruara në demostrata për statusin e Republikës së Kosovës, ndërsa me rastin kur Aliu në muajin nëntor të vitit 1981, duhej të shkonte në SHBA i jep detyra që atje të kontaktojë me ambasadorin e RPS të Shqipërisë dhe emigrantët për të kërkuar përkrahje dhe ndihmë, për të cilën gjë Aliu është pajtuar dhe e ka marrë për sipër.

I pand. Ekrem Kryeziu në deklaratën e dhënë gjatë hetimeve ka spjeguar se i pandehuri Mentor Kaçi pas demostratave me një

sistemi i RSFJ dhe u jepet përkrahje demostratave të marist dhe prillit në Kosovë dhe kërkesës së parashtruar për statusin e Republikës, të cilin pastaj e komentojnë dhe e vlerësojnë lartë. Duke u këthyer pastaj nga ky fshat për në Prishtinë, i pand. Ukshin i propozon që këta të dy në familje të shkojnë në SHBA ashtu që së pari do të shkojshin në Greqi në mënyrë legale, me ç'rast do të shkojnë në ambasadën e SHBA në Greqi, ku do të kërkonin azil politik e pastaj prej atje në SHBA, dhe një javë më vonë kur i pandehuri Ekrem shkon në shtëpinë e të pandehurit Ukshin për të biseduar rreth detalizimeve të kësaj shkuarje, ky i deklaron se atje pas kontakteve me përfaqsuesit e emisionit të RPSSH, organizatave emigrante dhe emigrant të ndryshëm do të vepronin prej atje në drejtim të luftës për fitimin e statusit të Republikës së Kosovës.

Kur është fjala për qëndrimin e të pandehurit Ali Kryeziut, deklaron se ai nuk është për një sistem socialist siç është ky te ne në Jugosllavi dhe se me rastin kur deshi të shkoj për SHBA si përfaqësues i organizatës punuese ku ishte i punësuar, i ka thënë se "Njëherit do ta shfrytzoj rastin dhe të mbledhi të holla nga emigrantët shqiptar për blerjen e armëve".

I pand. Ukshin Hoti në deklaratën e dhënë gjatë hetuesisë pranon dhe spjegon se në të vërtetë kur ishte për vizitë ke prindërit e tijë në fshatin Krushë e Madhe, së bashku me të pand. Ekrem Kryeziun dëgjuanë trakën e magnetofonit me inqizime të artikullit të gazetës së RPSSH "Zëri i Popullit" përkitazi me ngjarjet në Kosovë si dhe se në shtëpinë e vet në dy raste ka inqizuar emitimin në valët e radios dhe emitimit në TV të Tiranës artikujt të "Zërit të popullit", të cilët gjithashtu i janë kushtuar ngjarjeve të marsit dhe prillit të vitit 1981 në Kosovë si dhe se me një rast kur në shtëpinë e këtij kanë ardhë për vizitë të pandehurit Halil Alidema dhe Ekrem Kryeziu, ia kanë dhënë për ta lexuar pamfletin nga revista "Liria" të organizatës ilegale "Marksiste-Leniniste të Kosovës" me titull "Lufta e ..." por pas leximit të vetëm dy faqeve ua ka këthyer dhe ka deklaruar se nuk ka kurrëfar vlefte.

I pand. Hilmi Ratkoceri në deklaratën e dhënë gjatë hetuesisë spjegon se i pand. Halil Alidema që prej takimeve të para në vitin 1979 në Ferizaj ia ka eksponuar qëndrimet e tija armiqësore dhe pastaj i ka parashtruar pyetjet se a i pranon idetë e tijë dhe të punoj për organizimin e njerzëve në luftë për bashkimin e popullit shqiptar dhe për statusin e Republikës së Kosovës të cilat i ka pranuar dhe ka deklaruar se do të angazhohet në këtë drejtim. Dhe pastaj të pand. Halil sipas kërkesës së tij e ka njoftuar rreth shkruarjes së parullave me përmbajtje armiqësore në vitin 1979 në Shkollën e mesme ekonomike në Ferizaj dhe thyerjes së fotografisë së shokut Tito si dhe kush prej nxënësve i ka kryer këto akcione. Pastaj pas këthyerjes nga shërbimi ushtarak në qershor të vitit 1981 dhe pas kontakteve me të pand. Halil dhe spjegimeve të t'ia për ecuritë e demostratave dhe materialet propagandistike të organizatave ilegale që i posedon ky, i pand. Halil, sipas propozimit të tij merrë për sipër që në Shkollën ku ishte duke punuar t'i sigurojë geshtetnerin për shumzimin e materialit propagandistik, të kontaktoj me njerz dhe të formojë grupin e vet, në ç'drejtim edhe ka vepruar konkretisht, si dhe ta informoj detalisht për diskutimet në mbledhjet e LK të shkollës dhe si po i gjykojnë demostratat dhe çfar masash po ndërmirren në këtë drejtim, e krejtë këto në drejtim të luftës për fitimin e statusit të Republikës. Për rezultatet e përpjekjeve të veta vjen në Prishtinë dhe e njofton të pandehurin Halil, i cili cakton terminin e shkuarjes në Ferizaj për tu takuar me personat që kishte kontaktuar dhe për t'ju dhënë udhëzime dhe këshilla për veprimtarinë konkrete të mëtejmë dhe furnizuar me material propagandistik, pasi ky i pandehuri Hilmi nuk e kishte marrë nga i pand. Nezir Haliti sipas porosive të pandehurit Halil.

(...)

Në mbrojtje të pandehurit veç e veç deklarojnë:

Halil Alidema se në një orjentim të këtill armiqësor e ka nxitë moszhvillimi i mjaftueshëm i KSA të Kosovës dhe ngecja e sajë në krahasim me viset tjera të vendit, pastaj edhe kërkesat e parashtruara në demostrata për statusin e Republikës së Koso-

vës, ndikimi i përmbajtjes së pamfleteve që vet e pat gjetë në oborrin e shtëpisë së vet dhe ai që e mori nga i pand. Ekrem si dhe ndikimi me qendrimet e tyre të të pandehurëve Ukshin Hotit, Shemsi Reçica, Ekrem Kryeziut dhe të tjerë në një anë e në anën tjetër naiviteti i tijë dhe kompleksi inferior ndaj të tjerëve, të cilëve për tu treguar se din me mundet të bëjë shumë çka, shpeshëherë në biseda edhe i ka rritë gjërat dhe u ka treguar gjëra dhe raste të imagjinuara.

Ekrem Kryeziu, se (...) e lexojë pamlfetin nga revista "Liria" të organizatës ilegale "Marksiste-Leniniste të Kosovës" me titull "Lufta e popullit..." të cilin ia pat dhënë i pand. Mentor Kaçi, por këte e ka bërë vetëm nga kurreshtja intelektuale e asësesi me qëllim politike, ndërsa Halil Alidemes ia ka dhënë me qëllim që pasi ta lexoj ta shef se sa të pabaza janë ato që i përmbahet ky material dhe kështu do të ndikojë në këthelljen e tijë. Duke e njoftë Halil Alidemën si njeri i cili gjithmonë ka dëshirë t'i rritë gjërat, llafazan dhe se ka dëshirë të paraqitet dhe të lejë përshtypjen e njeriut që i di gjërat dhe mundet gjithshka të arrijë nuk iu ka dhënë rëndësi fjalëve dhe paraqitjeve të t'ia, por bile në shumë raste edhe është tallë me te duke i thënë edhe se a do ta pranojnë edhe këte në organizatën dhe a do ta thirrin në mbledhje, e bile nuk i ka dhënë rëndësi as asaj kur Halili i ka thënë që edhe ky, pra Ekremi si i pranuar në organizatën ilegale të angazhohet në formimin e grupit të "dhetshit" në TV Prishtina, si dhe kur i ka thënë se t'ia vizatojë skicën për objektet ushtarake dhe ato të transmetuesit televiziv në Golesh dhe për mundësinë e sigurimit të armëve, e thekson se kurrësesi nuk ia ka vizatuar këtë skicë. Kur e ka vrejtë qëllimin e të pand. Ukshin Hotit për shkuarjen në SHBA kategorisht ka qenë kundër kësaj.

Ukshin Hoti se pasi ka lexuar dy faqe të pamfletit nga revista "Liria" të organizatës ilegale "Marksiste-Lenininiste të Kosovës" me titull "Lufta e popullit ..." të cilën në shtëpinë e tij e suallën të pand. Halil Alidema dhe Ekrem Kryeziu, ua ka hudhë si të pavlefshme duke u thënë se nuk ka kurrëfar vlefte dhe se është mjaftë primitive. Lidhur me dhënien e statusit të Republikës së Kosovës, konsideron se ajo nuk është e

kundërshtim me zhvillimin socialist dhe vetëqeverisës të RSFJ por si bartës i ndonjë ndryshimi të till eventual mund të jetë vetëm LKJ e jo kurrësesi armiqët e këtë mendim e ka formuar pas demostratave. Në këtë drejtim ka biseduar në rrethin familjar dhe me miqët e vet e ndoshta edhe me të pandehurin Halil Alidemen, meqë është në gjendje që në pikëpamje teorike ta argumentojë dhe ta mbrojë këtë tezë. Inqizimet e artikujve të "Zërit të Popullit" nuk i ka bërë me ndonjë qëllim propagandistik por për ti studjuar më vonë përmbajtjet e këtyre artikujve.

Mentor Kaçi se pamfletin e organizatës "Marksiste-Leniniste të Kosovës" e ka gjetë para shtëpisë së vet dhe pasi e ka lexuar ia ka dhënë të pandehurit Ekrem, por jo me qëllim të propagandës, ndërsa shënimet për forcat e APJ dhe atyre policore, vendosjen dhe lëvizjen e tyre të pandehurit Halil ia ka dhënë sipas kërkesës së tij e bile nuk e din edhe pse kështu ka vepruar e thekson se ato shenime nuk janë të përpikëta ashtu flitej ato ditë në Gjakovë.

Hilmi Ratkoceri, se kështu ka vepruar sipas kërkesës së të pand. Halil Alidemes, nga i cili në një mënyrë ka qenë në mvarshmëri prej tij, sepse duhej ti ndihmonte edhe si më parë në dhënien e disa provimeve në fakultet, në të cilin Halili ka qenë i punësuar.

Ali Kryeziu, se nuk e ka lexuar pamfletin "Teoria dhe praktika e revolucionit" të cilin me të vërtet në një rast ia ka dhënë i pand. Halil, por të njejtin vetëm e ka shfletuar ashtu kalimthazi, andaj as që e ka komentuar të njejtin. Lidhur me bisedat me të pandehurin Halil pas demostratave, në të vërtetë e ka pranuar kërkesën e parashtruar për statusin e Republikës së Kosovës dhe mendon se ajo nuk është në kundërshtim me zhvillimin socialist vetëqeverisës të RSFJ, por bartës i kësaj kërkese nuk mund të jenë armiqët. Lidhur me propozimet që ia ka bërë i pand. Halil me rastin kur duhej të shkonte në SHBA në udhëzim zyrtar, ato nuk i ka aprovuar në pohim anipse i ka thënë se çdo gjë do të jetë në rregull, por këte e ka bërë me qëllim që ti largohet dialogut lidhur me këte, e nuk ka patur tjera biseda për ndërmarrjen e veprimeve konkrete të ç'fardo natyre ato qofshin.

Nezir Haliti, se me të pand. Halil Alidemen pas demostratave të marsit dhe prillit 1981, asnjëherë nuk ka biseduar e as që janë marr vesh me te për ndonjë veprim konkret apo të angazhimit të tijë për ndonjë veprim të tillë, ndërsa bisedat me të pand. Halil Alidemen në kafenën "Pranvera" në Ferizaj, kanë qenë në vitin 1979 dhe me atë rast kanë qenë në një tavolinë edhe qytetarët tjerë andaj për këtë arësye rezulton si apsurde deklarata e të pandehurit Halil se kemi biseduar ndonjë gjë me karakter armiqësor sepse vet situate nuk e ka lejuar këte.

Shemsi Reçica, se nuk i ka përkrahur demostratat në biseda dhe kontakte me të pand. Halil Alidemën dhe as që këtij i ka deklaruar për nevojën e vazhimit të mëtejmë në demostrata apo ndonjë mënyrë tjetër për realizimin e kërkesave të parashtruara në demostrata, anipse i pand. Halil në këtë drejtim e ka provokuar në shumë raste, ndërsa inqizimin në shiritin magnetofonik të artikut "Zëri i Popullit" e ka bërë nga kurreshtja, por pa qëllime të propagandimit. Lidhur me bisedat me antarët e konzullatës së RPSSH në Bullgari që ka patur në Varnë gjatë pushimeve verore, thekson se ato nuk kanë qen të natyrës politike apo të propagandimit armiqësor, anipse me këta i kanë diskutuar demostratat dhe situatën politike në Kosovë pas demostratave e shton se vet u ka kundërshtuar qëndrimeve dhe publikimeve të gjerave të pavërteta në mjetet e informimit të RPSSH, duke e thënë se të vërteta për demostrata janë ato që janë publikuar zyrtarisht ke ne.

Muharrem Fetiu, se me të vërtetë i pandehuri Halil Alidema është eksponuar para tijë me qëndimin armiqësor duke i përkrahur demostratat duke folur për organizatat ilegale dhe materialet propagandistike të këtyre organizatave dhe duke i vlersuar lartë aktivitetet dhe qëndrimet e këtyre organizatave në përpjekje për destabilizimin politik dhe kërkesat e tyre për Republikën e Kosovës si edhe se nga ky ka kërkuar që të angazhohet për aktivizimin e njerzëve në Komunën e Suharkes për veprimtarinë armiqësore, por thekson se duke e njoftë të pand. Halil si njeri që gjithmonë ka pasë dëshirë që ti rritë gjërat dhe të tregohet si i aftë në çdo pikëpamje, po edhe si llafazan,

nuk e ka dhënë rëndësi qëndrimeve të tijë e aq më tepër kur kështu ka vepruar para pothuajse çdo të njohuri por edhe para personave të cilët për herë të parë i ka pa.

Mbrojtjet e këtilla të pandehurëve nuk mund të aprovohen sepse në radhë të parë në të shumtën janë në kundërshtim me vet deklaratat e tyre dhe të njeri tjetrit dhënë gjatë hetuesisë, e kanë për qëllim vetëm për ta fshehur qëllimin e aktivitetit të tyre për veprimtari armiqësore dhe angazhimin në këtë veprimtari, e kështu ti shmangën përgjegjsisë penale.

Kështu mbrojtja e të pand. Halil Alidems nga vet deklarata e tijë si dhe në mbështetje të deklaratave të gjithë të pandehurëve tjerë, se veprimet inkriminuese i ka ndërmarrë nga naiviteti dhe inferioriteti ndaj të tjerëve, është palogjikshme, sepse veprimtaria e tijë armiqësore daton që nga viti 1978 dhe është iniciatori i lidhshmërisë së veprimtarisë me të gjithë të pandehurit tjerë para dhe pas demostratave.

Nga deklarata e të pandehurit Halil Alidemes vërtetohet se edhe mbrojtja e të pandehurit Ekrem Kryeziut është e pabazë dhe e orjentuar në shmangëjen e përgjegjsis penale, sepse ai në tërësi i ka përkrahë demostratat dhe kërkesat e parashtruara e në drejtim të realizimit të këtyre kërkesave ka ndërmarrë edhe veprime konkrete siq janë: furnizimi dhe leximi e komentimi dhe analizimi i materialeve propagandistike, pastaj vizatimi i skicës për objektet transmetues në Golesh, ofrimi i njohurive për mundësinë e sigurimit të armëve nga depot e TV Prishtinës dhe atyre ushtarake, pastaj deklarimi i të pandehurit Halil se do të angazhohet për kontaktimin dhe bindjen e personave në TV të Prishtinës për veprimtari armiqësore, ndërmjetësimi në mes të pand. Halil Alidemes dhe Ukshin Hotit e shumë veprime tjera, tregojnë se është fjalë për ndërmarrjen e veprimtarisë me dashje në drejtim të akcioneve konkrete armiqësore.

Mbrojtja e të pandehurit Ukshin Hotit se kur ka folë për të drejtën e statusit të Republikës së Kosovës, ka theksuar se ajo mund të realizohet vetëm në bazë të diskutimeve dhe në suazat e qëndrimeve të Lidhjes komuniste, gjithashtu është e pa bazë, nga se me deklaratat e të pandehurëve Halil Alidemes dhe

Ekrem Kryeziut, vërtetohet e kundërta e kësaj, dhe se i pand. Ukshin ka ndërmarrë dhe ka propozuar akcione konkrete në drejtim të realizimit të kërkesës së statutit të Republikës së Kosovës, jashtë suazave të qëndrimeve të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë dhe zhvillimit socialist e vetëqeverisës të ventit.

Të pabaza gjithashtu janë edhe mbrojtjet e të pand. Mentor Kaçit kur thot se shenimet për numrin e forcave të APJ dhe atyre policore si dhe vendosja e lëvizja e tyre në Komunën e Gjakovës, të pand. Halil ia dha pa ndonjë qëllim të caktuar si dhe se pamfletin nga revista "Liria" pa qëllim propagandistik e ka lexuar dhe ia ka dhënë të pandehurit Ekrem Kryeziut si dhe ajo e Hilmi Ratkocerit se ka vepruar për shkak të mvarshmërisë nga i pand. Halil Alidemaj, i cili do ti ndihmonte në dhënien e provimeve në fakultet, nga se që të dyt, në bazë të propozimeve dhe kërkesave që ua parashtrojë i pand. Halil e kishin të kjartë veprimtarinë armiqësore dhe pranuanë aktivitetin e tyre dhe angazhimin për veprim të mëtejmë dhe ndërmuarën edhe veprime konkrete në këtë drejtim siq janë theksuar më lartë.

Në bazë të deklaratave të të pandehurëve Halil Alidemes dhe Ekrem Kryeziut gjithashtu vërtetohet si e pabazë edhe mbrojtja e të pand. Ali Kryeziut.

Në bazë të deklaratës së të pand. Halil Alidemes si dhe asaj të Hilmi Ratkocerit, mbrojtja e të pandehurit Nezir Halitit se nuk ka ndërmarrë veprimet inkriminuese dhe se me të pand. Halil nuk ka biseduar dhe nuk ka pranuar angazhimin e tij të mëtejmë pas demostratave të marsit 1981 dhe se në kontaktet e vitit 1979 me të pandehurin Halil Alidemen nuk ka patur biseda me karakter armiqësor gjithashtu vërtetohet si e pabazë.

Në bazë të deklaratës së të pandehurit Halil Alidemes si dhe të dëshmitarit Gani Osmanit, rezulton si e pabazë edhe mbrojtja e të pand. Shemsi Reçices e nga vet deklarata e tijë në një mënyrë vërtetohet se është angazhuar dhe është aktivizuar në aktivitetin armiqësor nga se i inqizoj në magnetofon artikujt e "Zërit të Popullit" të cilët kanë sulmuar sistemin politiko-shoqëror dhe vetëqeverisës të RSFJ e kontaktojë menjëherë pas demostratave me përfaqësuesit e konzullatës së RPSSH në Bullgari.

Nga vet deklarata e të pand. Muharrem Fetiut vërtetohet se që më kohë i ka qenë e kjartë se i pandehuri Halil Alidema është duke përgaditur kryerjen e veprës penale, andaj edhe pse ka mundur që me lajmërim të parandalohet kryerja e sajë, nuk e ka lajmëruar e pastaj i pandehuri Halil edhe e kreu veprën penale për të cilën mund ti jepët denimi me burg prej 5 vjetësh dhe më i rëndë.

Pas demostratave të marsit dhe prillit 1981 në Kosovë ato janë vlerësuar dhe është vërtetuar karakteri kontrarevolucionar i tyre. Përkundër kësaj të gjithë të pandehurit jo vetëm që i përkrahën demostratat armiqësore e irredentiste të muajëve mars dhe prill 1981, por në shumë takime e biseda vazhduanë aktivitetin armiqësor në ndërmarrjen e akcioneve konkrete dhe të planifikimit për ndërmarrjen e akcioneve tjera të mëtejme. Kishin për qëllim që të sigurojnë kontinuitet të veprimtarisë armiqësore, të organizimit të demostratave të sërishme, të shpërndarjes së parullave, afisheve e pamfleteve me përmbajtje armiqësore dhe njëherit të shkaktojnë edhe mëtutje shqetësim në opinion dhe të mbajnë gjendjen e ndërlikuar në krahinë. Prandaj këto akcione të elementeve armiqësore në realitet paraqesin tradhëti ndaj revolucionit tonë, ndaj sistemit tonë dhe janë akt tradhtie ndaj intersave të klasës punëtore dhe të vet kombësisë shqiptare.

(...)

Për këtë arësye dhe nga çka u tha më lartë, në veprimet e të pandehurëve Halil Alidemes, Ukshin Hotit, Ekrem Kryeziut, Mentor Kaçit, Hilmi Ratkocerit, Ali Kryeziut, Nezir Halitit, Shemsi Reçices dhe Muharrem Fetiut, pasqyrohen elementet qenësore të veprave penale për të cilat u akuzuanë e duhet të shpallën fajtor dhe të denohen sipas Ligjit.

(Përgatiti: Hamza Kokollari, Mars 2014)